

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË JETËS SË KREDIMARRËSIT

Neni 1

PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

1. Këto kushte të përgjithshme për sigurimin e jetës së kredimarrësit, këtu e më poshtë do të quhen "Kushte të Përgjithshme" rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet palëve në kontratën e sigurimit të jetës.

2. Kushtet e përgjithshme të sigurimit të jetës janë pjesë përbërëse Kontratës së Sigurimit që Kontraktuesi/I Siguruarit lidh me Kompaninë e Sigurimeve SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA (këtu e më poshtë do të quhet Siguruesi).

Neni 2

PËRCAKTIMET

1. "SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA Sh. A." – Kompania e sigurimeve SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. - Kosovë, Prishtinë, e autorizuar nga BQK për klasat e sigurimit të jetës.

2. "Policëmbajtësi" – Përcaktohet në kërkesën për sigurim ose në çdo ndryshim të mëtejshëm të pasqyruar në dokumentacionin e Siguruesit. Ndërsa i siguruarit jeton, dhe në varësi të transferimit të të drejtave me miratimin e Siguruesit, vetëm policëmbajtësi ka të drejtën të marrë të gjitha përfitimet dhe të ushtrojë të gjitha të drejtat që jep kjo policë ose që miraton Siguruesi.

3. "Përfituesi(t)" – Përcaktohet(n) në kërkesën për sigurim ose në çdo ndryshim të mëtejshëm të pasqyruar në dokumentacionin e Siguruesit. Siguruesi do t'i paguajë përfituesit(ve) përfitimin e pagueshëm, në përputhje me kushtet e kësaj police.

4. "I siguruar" – Individ i kredimarrës për kredi individuale (përfshirë të gjitha produktet kreditore të bankës) dhe individi "person kyç" (pronar, bashkëpronar, drejtues biznesi) ("Key person" ose "Key Man") kredimarrës i policëmbajtësit për kredi jo individuale (te gjitha llojet e produkteve kreditore për ndërmarrje), në moshën nga 18 deri në 70 vjeç në kohën e marrjes në sigurim.

5. "Ngjarje sigurimi" – Ngjarje e ardhshme, e pasigurt, që ndodh, shfaqet brenda periudhës së siguruar dhe që është e pavarur nga vullneti i të siguruarit, që sjell si rrjedhojë të drejtën e policëmbajtësit/përfituesit për të kërkuar përfitimin e pagueshëm.

6. "Shumë sigurimi" – Shuma e përcaktuar si e tillë në policën e sigurimit. Shuma maksimale e sigurimit do të jetë 300,000€ për çdo rast të siguruar. Për shumën e sigurimit më të lartë se EUR 300,000€ deri në limitin maksimal të kapacitetit të marrëveshjes së risigurimeve, do të bëhen vetëm me miratimin e siguruesit, nëse palët në marrëveshje bien dakord paraprakisht ndryshe.

7. "Shuma e pakthyer e kredisë" – Shuma e pakthyer e principalit të borxhit të kredimarrësit ndaj bankës, në datën e caktuar, në përputhje me tabelën origjinale të amortizimit të kredisë (duke përfshirë pagesat e vonuara, interesat për pagesat e vonuara dhe çdo komision/shpenzim tjetër bankar).

8. "Përfitimi i pagueshëm"

Ne varësi zgjedhjes së klientit në Kërkesë për sigurim apo Policë Sigurimi përfitim i pagueshëm mund të jete njëra prej pikave më poshtë apo kombinimi i tyre.

- 8.1 Shuma e mbetur e kredisë në datën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.
- 8.2 Shuma e fillestare e kredisë.
- 8.3 Në rastet kur ngjarja e sigurimit është paaftësi e pjesshme e përhershme përfitimi i pagueshëm do të jete një përqindje e shumës së sigurimit e përcaktuar me shkallën e përcaktimit të përqindjes për paaftësi të pjesshme e të përhershme sipas tabelës së përfitimeve në rast të paaftësisë së pjesshme të përhershme.
- 8.4 Në çdo rast, përfitimi i pagueshëm në total ndaj një apo disa përfituesve nuk do të jetë më i lartë se shumën e sigurimit.
- 8.5 Në rast se ka pasur vonesë në kthimin e kredisë, me kërkesën e përfituesit, shumës së pakthyer do t'i shtohen deri në 3 (tre) këste të papaguara si përfitim i pagueshëm.
- 8.6 Në rastin kur vetëm Banka është përfituese, përfitimi i pagueshëm do të jetë vetëm shumën e pakthyer e kredisë.
- 8.7 Në rastin kur ka përfitues të tjerë (familjare, etj.), përfitimi për përfituesit tjerë do të jetë në varësi si përcaktohet nga kontraktuesi/i siguruarit në kërkesën për sigurim apo policën e sigurimit.

9. "Monedha" – Monedha e kredisë.

10. "Aksident" – Një ngjarje e papritur dhe e paparashikuar që ndodh pa vullnetin e të siguruarit, e identifikueshme për sa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të siguruarin.

Rastet e qe nuk konsiderohen aksident janë: Mbingarkesa, zgjatja e muskujve, zhvendosja habituale, thyerje patologjike, infektionet, pickimi nga insektet, ngrirjet, goditja nga dielli, goditja nga nxehtësia, neglizhenca profesionale mjekësore.

11. "Humbje Jete Natyrore"

11.1 Humbje jete e të siguruarit si pasojë e një sëmundje ose mosfunksionimit të organeve të brendshme të trupit.

11.2 Qe nuk është e ndikuar nga forcat e jashtme.

11.3 Humbja e jetës së të siguruarit brenda periudhës së sigurimit si rrjedhojë e drejtpërdrejt e shkaqeve natyrore që i është shfaqur brenda periudhës së siguruar.

12. "Humbje Jete Aksidentale"

12.1 Humbja e jetës së të siguruarit si rrjedhojë e një aksidenti që ndodh brenda periudhës së sigurimit.

12.2 Me pasojë humbjen e jetës brenda 12 muajsh nga data e ndodhjes së aksidentit, kurse pas kalimit të kësaj periudhe nuk do të konsiderohet si humbje jete nga aksidenti, por nga shkaqe tjera sipas kësaj kontrate.

13. "Paaftësi e Plotë e Përhershme" – Humbja e aftësisë së të siguruarit për të punuar, e shkaktuar nga aksidenti që e parandalon plotësisht të siguruarin për t'u marrë me çdo veprimtari ekonomike ose punë të çdo lloji dhe që zgjat dymbëdhjetë muaj dhe në fund të kësaj periudhe është pa shpresë për mirësim.

14. "Paaftësi e Pjesshme e Përhershme" - Humbja e aftësisë së të siguruarit për të punuar, e shkaktuar nga aksidenti që rezulton në humbje anatomike ose humbje funksionale të përhershme të një ose disa prej organeve ose gjymtyrëve të siguruar, sipas përcaktimeve të "Tabelës së Përfitimeve".

15. "Paaftësi e Plotë e Përkohshme" – Humbja e aftësisë së të siguruarit për të punuar, e shkaktuar nga aksidenti që e ndalon të siguruarin tërësisht të kryejë veprimtarinë e tij ekonomike ose çdo lloj punësimi për një periudhë kohe minimalisht 3 (tre) dite dhe qe mund te vazhdoje deri në 180 ditë për periudhën e sigurimit, subjekt i pajtimit mes palëve. Një kompensim ditor si pasojë e aksidentit (max. 30 Euro) mund të ofrohet sipas pajtimit mes palëve.

16. "Gjendje ose sëmundja para ekzistuese" – Çdo sëmundje apo plagë e cila në lidhje me vlerësim mjekësor ka filluar para periudhës së sigurimit apo një sëmundje/mosfunksionim i lindur. Gjendje për të cilën i siguruarit ka pasur apo nuk e kishte njohur para periudhës së sigurimit.

17. "Gjendje e lindur dhe kronike" – Çdo sëmundje e lindur apo sëmundje kronike për të cilën i siguruarit ka pasur apo nuk e kishte njohur para periudhës së sigurimit.

18. Tabela e Përfitimeve në rast paaftësie e pjesshme e përhershme

18.1 Tabela e Përfitimeve

	Paaftësi e Pjesshme e Përhershme	Ndaj shumës së kredisë	
		Djathtë	Majtë
	Humbja e plotë anatomike dhe funksionale e:		
1.	Gjymtyrës së sipërme mbi bërryl	70%	60%
2.	Një krah ose parakrah	60%	50%
3.	Bllokim i plotë i kyçit të dorës	40%	30%
4.	Gishtit të madh të dorës	18%	16%
5.	Gishtit tregues të dorës	14%	12%
6.	Gishtave të tjerë të dorës	8%	6%
7.	Gishtit të vogël të dorës	12%	10%
8.	Një prej falangave të gishtit të madh të dorës	9%	8%
9.	Një prej falangave të gishtave të tjerë të dorës	1/3 e gishtit	

10.	Humbja e plotë dhe e pakthyeshme e shikimit të një syri	40%
11.	Një këmbë poshtë kyçit të këmbës	40%
12.	Një këmbë mbi gju	60%
13.	Një këmbë në ose poshtë gjurit	50%
14.	Bllokim i plotë i kofshës deri në brez	40%
15.	Bllokim i plotë i përdorimit të këmbës në nivelin e kyçit	30%
16.	Gishtit të madh të këmbës	5%
17.	Gishtat e tjerë të këmbës	3%
18.	Një falange të gishtit të madh të këmbës	2.5%
19.	Një falange të gishtave të tjerë të këmbës	1%
20.	Humbja e plotë dhe e pakthyeshme e dëgjimit të një veshi	10%
21.	Humbja e plotë dhe e pakthyeshme e dëgjimit të të dy veshëve	40%
22.	Shpretka	10%
23.	Një veshke	30%
24.	Unazat e qafës – te boshtit kurrizor te dëmtuara	10%
25.	Boshti kurrizor	7%
26.	Humbja e plote dhe e pakthyeshme e shikimit të të dy syve	100%
27.	Humbja e plote fizike e funksionale e dy ose me shume gjymtyrëve se bashku	100%
28.	Humbja e një syri dhe një gjymtyre	100%

18.2 Ne rastet kur I siguruari është mëngjarash (left-handed) përqindja e përfitimeve ne listën prej numrit 1-8 do te ndryshoj e djathta me te majtën rrjedhimisht do ti takoj përfitime me te mëdha ne pjesë te dorës se majtë.

18.3 Siguruesi ne përpikëri te plote do te përcaktoj përqindjen e përfitimit për Paaftësi te pjesshme te përhershme për rastet qe nuk janë te cekura ne listën nga 1-28.

Neni 3

MBULIMI NË SIGURIM

- Siguruesi do t'i paguajë policëmbajtësit/përfituesit përfitimin e pagueshëm në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.
- Në varësi të zgjedhjes së të siguruarit në kërkesën për sigurim apo policë, dhe të parashikimeve të Kushteve të Përgjithshme dhe dokumentacionit shoqërues, ngjarje sigurimi do të jetë një apo me shumë nga mbulimet me poshtë:
 - Humbje Jete Natyrore
 - Humbje Jete Aksidentale
 - Paaftësi e Plotë e Përhershme
 - Paaftësi e Plotë e Përkohshme
 - Paaftësi e Pjesshme e Përhershme

Neni 4

PËRJASHTIME TË PËRGJITHSHME

- Siguruesi nuk do të mbulojë humbjen e jetës ose paaftësinë e të siguruarit që është rrjedhojë direkte ose indirekte e:
 - Luftës, pushtimit, veprimeve të armikut të jashtëm, armiqësive/luftimeve (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, dhe kryengritjes.
 - Reaksionit bërthamor, rrezatimit bërthamor ose ndotjes radioaktive, pavarësisht nga burimi i tyre.
 - Veprimeve keqdashëse të kryera nga përfituesi ose partnerët e tij kundër interesave të të siguruarit.
 - Dehjes, përdorimit të tepërt të psikofarmaceutikëve, ilaçeve ose halucinantëve.
 - Sindromës së Deficiencës Imunitare të fituar dhe sëmundjeve të lidhura me të.
 - Sëmundjet e lindura dhe sëmundjet kronike.

- Sëmundjet/Gjendjet paraekzistuese sipas definimit mes palëve.
- Vetëvrasjes ose tentativës për vetëvrasje gjatë 12 muajve të parë të sigurimit.
- Dëmtimeve të shkaktuara ndaj vetvetes.
- 10 Pjesëmarrjes në sporte të rrezikshme si parashutimi, ngjitjet malore, fluturimet me avionë pa motor, zhytjeve nënujore, dhe garave sportive motorike.

Neni 5

INDIVIDË QË NUK SIGUROHEN

- Siguruesi nuk ofron mbulim në sigurim për:
 - 1.1 Individë që vuajnë nga alkholizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoia, dhe sindroma organiko-cerebrale.
 - 1.2 Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm.
 - 1.3 Individë mbi 70 vjeç. Të siguruarit që arrijnë moshën 70 vjeç gjatë periudhës që sigurimi është në fuqi do të qëndrojnë të siguruar deri në fund të këtij viti sigurues.
 - 1.4 Individë më të rinj se 18 vjeç.

Neni 6

PERIUDHA E SIGURIMIT

- Periudha e sigurimit do të jetë e njëjtë me periudhën origjinale të kthimit të kredisë, maksimumi 20 vjet, përveçse kur është rënë dakord ndryshe me shkrim nga Siguruesi.
- Në varësi të përmbushjes së kriterëve të marrjes në sigurim dhe pagesës së primit të duhur, mbulimi në sigurim do të fillojë me disbursimin e kredisë dhe do të përfundojë në datën më të hershme prej:
 - Përfundimi i periudhës origjinale të kredisë.
 - Rikthimi i plotë i shumës së kredisë.
 - Arrija e moshës 70 vjeç nga i siguruari.
 - Ndodhja e ngjarjes së sigurimit.

Neni 7

PAGESA E PRIMIT

- Primi i sigurimit paguhet si prim i vetëm, prim vjetor ose mujor, që llogaritet mbi shumën origjinale të sigurimit apo mbi shumën e pakthyer të kredisë, në varësi të marrëveshjes mes palëve. Primi do të paguhet brenda një afati prej max. 45 ditësh nga përfundimi i muajit në të cilin fillon periudha e sigurimit.
- Nëse primi nuk paguhet si më sipër, atëherë kjo policë nuk ka vlerë dhe mbulimi i dhënë prej saj përfundon prej fillimit (ab initio).

Neni 8

KONTRATA

- Kontrata e sigurimit përbëhet nga policia bazë (police individuale apo grupe) dhe çdo përfitim shtesë që i bashkëngjitet, shtojcat dhe kërkesa(t) për sigurim. Siguruesi mbështetet në kërkesën(at) për sigurim dhe deklaratimet e të siguruarit dhe policëmbajtësit për të lëshuar këtë policë sigurimi. Të gjithë deklaratimet në kërkesën(at) për sigurim konsiderohen si të vërteta për personat që i kanë bërë.
- Siguruesi nuk do të detyrohet nga ndonjë premtim ose deklaram i bërë nga çdo përfaqësues ose person tjetër përveçse siç përcaktohet më sipër.

Neni 9

NJOFTIMET DHE DEKLARIMET E TË SIGURUARIT DHE POLICËMBAJTËSIT

- Njoftimet dhe deklaratimet e të siguruarit dhe policëmbajtësit duhet të jenë të plota dhe të mjaftueshme.
- I siguruari dhe policëmbajtësi duhet t'i japin Siguruesi çdo informacion që ka lidhje me të siguruarin.
- Nëse, pas lëshimit të policës së sigurimit, mësohet se i siguruari dhe/ose policëmbajtësi kanë paraqitur informacion jo të vërtetë, ose nuk kanë paraqitur informacion thelbësor, Siguruesi do të ketë të drejtë:
 - 3.1 Të kundërshtojë vlefshmërinë e kontratës brenda tre muajve nga data që ka mësuar për pavërtetësinë ose mosparaqitjen e informacionit, duke kryer ndryshime në kushtet e përgjithshme dhe pjesë të tjera të kontratës.

- 3.2 Të anulohet kontratën në rast se nuk do ta kishte lëshuar policën e sigurimit nëse do të kishte pasur dijeni për këtë informacion në momentin e lëshimit.
- 3.3 Të refuzojë pagesën e të ardhurave/përfitimeve.

Neni 10

NJOFTIMI I NGJARJES SË SIGURIMIT

- Me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, policëmbajtësi/përfituesi duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesi, brenda një afati prej max. 60 ditësh nga ndodhja e ngjarjes, duke specifikuar rrethanat dhe pasojat.
- Siguruesi duhet t'i vihen në dispozicion dokumentacioni vijues për çdo rast sigurimi:
 - Humbja e Jetës së të Siguararit
 - Certifikata e lindjes, Letërnjoftim apo Pasaporta e të siguararit
 - Certifikata e vdekjes së të siguararit
 - Raporti mjekësor për kohën, shkaqet e vdekjes, etj.
 - Dokumentacioni që vërteton shumën për t'u paguar nga Siguruesi.
 - Dokumente të tjerë mjekësore nëse është e nevojshme.
 - Paafhtësia e Plotë/pjesshme e Përhershme/përkohshme
 - Certifikata e lindjes, Letërnjoftim apo Pasaporta e të siguararit
 - Raporti mjekësor për kohën, rrethanat e ngjarjes, etj.
 - Dokumentacioni që vërteton shumën për t'u paguar nga Siguruesi.
 - Dokumente të tjerë mjekësore nëse është e nevojshme
- Siguruesi mund të kërkojë dokumentacion/prova më specifike për sa i përket shkallës së paafhtësisë dhe shkaqeve të saj.

Neni 11

KËRKESAT PËR PAGESË

- Në rast kërkesash për pagesë të vlefshme Siguruesi do t'i paguajë policëmbajtësit përfitimin e pagueshëm brenda 60 ditësh nga marrja e dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara, në varësi të marrëveshjes mes palëve.

Neni 12

SUBROGIMI

- Pagesa e të ardhurave do të kryhet kundrejt kalimit tek Siguruesi të të gjitha të drejtave të policëmbajtësit në marrëveshjen e kredisë dhe asnjë person apo autoritet nuk do të veprojë për të parajgykuar këto të drejta.

Neni 13

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

- Kontraktuesi/i siguarari, me një deklaram ose me një veprim të qartë pohues, shprehë pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të;
- Siguruesi ka për detyrë informimin, njoftimin dhe udhëzimin që Siguruesi do të mbledhë, ruajë, përpunojë dhe transferojë të dhënat e kontraktuesit/te siguararit personale në formë elektronike dhe/ose të shtypur vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe vetëm për kohëzgjatjen e kërkuar me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 14

KUFIZIMET E SANKSIONEVE DHE KLAUZOLA PËRJASHTUESE

- Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi për aq sa ofron mbulim sigurimi nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk

bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.

Neni 15

JURIDIKSIONI

- Çdo kundërshti mbi këtë marrëveshje që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok është juridiksion i legjislacionit të Kosovës dhe gjykatës kompetente.

Neni 16

TË NDRYSHME

- Palët mund të pajtohen dhe për kushte të veçanta që do të mbizotërojnë në raport me këto kushte të përgjithshme, me rastin e firmosjes së tyre.

KUSHTET E VEÇANTA

TE SIGURIMIT TE JETES SE KREDIMARRRESIT ONLINE

Neni 1

POLICA E SIGURIMIT ONLINE

- Polica do të lëshohet vetëm në formë elektronike te cilën klienti do të pranojë në emali pasi të behet pagesa.
- Nëse klienti kërkon police të printuar dhe nënshkruar nga kompania mund të paraqitet në zyrë qendrore të Siguruesit për të pranuar atë.
- Ne rast se të dhënat në polica janë të gabuara si shkak i gabimit të klientit apo gabim tjetër teknik, klienti duhet të njoftojë Siguruesin brenda 24 orëve nga koha kur e ka pranuar policen.
- Ne rast se Siguruesi vëren ndonjë gabim në të dhëna të klientit duhet të njoftojë klientin brenda muajit të parë të sigurimit, dhe të kërkojë ndryshim të Polices.
- Kjo police do të ketë mundësinë e rinovimit automatik.